LIGJ
Nr.9529, datë 11.5.2006

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË LIGJIN NR.9367, DATË 7.4.2005 "PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Në shkronjën "a" të pikës 5 të nenit 15 fjalët "Përjashtuar burimet e krijimit të tyre" zëvendësohen me fjalët "dhe burimet e krijimit të tyre".

Neni 2

Në shkronjën "b" të nenit 28 shtohen fjalët "të avokatisë", "ekspertit të licencuar", "të konsulentit".

Neni 3
Dispozitë kalimtare

Zyrtarët, që kanë filluar punë për herë të parë në njërin nga funksionet që mbartin detyrimin për deklarim dhe e kanë kryer deklarimin para fillimit të punës, në zbatim të nenit 15 të ligjit, plotësojnë justifikimin e burimeve të krijimit të interesave privatë, të deklaruara brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ky detyrim nuk zbatohet për ata zyrtarë, që i kanë justifikuar vullnetarisht burimet.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4892, datë 2.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu